



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **96**

Prishtinë, më 3.12.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina dhe Boban Todorović.

Mungoi : Daut Haradinaj, Nijazi Idrizi dhe Liburn Aliu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 19.11.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për shfrytëzimin dhe administrimin e ndërtesave në bashkëpronësi,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime, ndërkaq kryetari njoftoi për mungesën e arsyeshme të dy anëtarëve të Komisionit (Salih Morina dhe Boban Todorović) të cilët janë pajtuar me rendin e ditës për mbledhjen e sotme me shtesat në pikën të ndryshme rreth Projektligjeve të cilat duhet të përcjellën në leximin e dytë.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.11.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 19.11.2012, njëherit Komisioni nuk u deklarua rreth vërejtjeve dhe shpjegimeve nga stafi rreth mënyrës së miratimit të procesverbalit ndonjëherë, në rast urgjencës. Gjatë javës së kaluar stafi i këtij komisioni, sipas kërkesës së zyrtarëve të administratës së Kuvendit, ka sqaruar për miratimin e procesverbaleve në komision, në rastet e urgjente.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për shfrytëzimin dhe administrimin e ndërtesave në bashkëpronësi

Kryetari i Komisionit Nait Hasani përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi ekspertin nga Amerika z. **Bill Donovan** nga thesari Amerikan, me të cilin janë bërë konsultimet çfarë duhet të ndryshoi në Projektligjin e dërguar nga Qeveria. Përfaqësuesja e projektit rreth financimit për banim në Kosovë znj. **Valentina Haziri** – Koorditore e projektit, shprehu gatishmërinë për të ndihmuar Komisionin rreth hartimit të vërejtjeve në këtë Projektligj, ndaj në vazhdim paraqiti konceptet ligjore të projektit duke potencuar disa çështje siç janë :

- ky Projektligj nuk adreson krijimin e ndërtesës në bashkëpronësi,
- bankat duhet të japin një hipotekë për banesë për çka janë bërë konsultimet edhe me ekspertët për patundshmëri,
- gjithashtu ky Projektligj nuk adreson si duhet çështjen e qeverisjes, pronarët duhet të vendosin a duhet të caktohet administratori etj,
- me Ligj duhet të themelohen shoqatat e pronarëve, krijimi i ndërtesës në bashkëpronësi si dhe kushtet për kredidhënësit për të marr banesat si hipotekë dhe shumë dilema tjera.

Në emër të Komisionit **Nait Hasani** falënderoi dhe kërkoi nga udhëheqësit e projektit që bashkërisht me zyrtarët e MMPH në ditët në vijim të gjejnë opsionin më të mirë dhe më të përshtatshëm për marrëdhëniet banesore në Kosovë duke sugjeruar për secilin Nen të Projektligjit vërejtjet konkrete, për të vazhduar javën tjetër Komisioni të nxjerr amendamentet rreth Projektligjit në fjalë.

Koordinatorja gjithashtu falënderoi duke parashtruar edhe disa pyetje sqaruese, që do të mirën parasysh gjatë hartimit të vërejtjeve.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit Nait Hasani ftoi Komisionin për përcjelljen e 4 Projektligjeve në leximin e dytë pasi që ka përfunduar procedura para Komisioneve të përhershme, si vijon :

- Amendamenti 3 për Projektligjin për Bjeshkët e Nemuna riformulohet si vijon : **Neni 3, nënparagrafi 1.3 i riformulohet : Zona e tretë - e shfrytëzimit të qëndrueshëm përfshinë pjesët e territorit të Parkut kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" ku mund të bëhet : ndërtim, rindërtim, mbrojtje të objekteve tradicionale dhe rekreacion, turizëm dhe nevoja të banorëve në territorin e Parkut Kombëtar si dhe shfrytëzim të kullosave dhe shfrytëzim ekonomik i të mirave të natyrës sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës si dhe në harmoni me ligjet përkatëse dhe Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar.**
- Amendamenti 5 për Projektligjin për Bjeshkët e Nemuna riformulohet si vijon : **Neni 4, riformulohet : Punët për administrimin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" i kryen Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" me seli në Pejë të cilën Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e themelon në afat prej gjashtë (6) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.**

Këto ndryshime rreth formulimit të dy amendamenteve Komisioni i bëri për shkak se është dashur të përshtatet sipas kohës së hyrjes në fuqi të Ligjit dhe të hiqen sugjerimet e

Komisionit nga Amendamenti 3 për hidrocentrale, energji me erë etj. Teksti i Amendamentit 3 vlenë edhe për Projektligjin për Sharrin.

Projektligji për Mbrojtjen e Bimëve dhe për **Rexhistrimin e Bujqësisë** gjithashtu përcjellën mbledhjes plenare për leximin e dytë me amendamentet e sugjeruara nga Komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 12,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani